



KONTROLLIMI EKSTERN I NJOHURIVE
TË NXËNËSVE TË KLASËS SË NËNTË

KATALOGU I PROVIMIT

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

VITI MËSIMOR 2012/2013

Katalogun e provimit e përgatitën:

Aishe Resulbegu, SHF " B.Strugar", Ulqin

Ali Daci, SHF "Dacaj", Rozhajë

Valbona Kroma-Hoxha, SHF "M.Tito", Ulqin dhe Fakulteti Filozofik, Podgoricë

Mr. Anton Goçaj, Enti i Shkollimit dhe Fakulteti Filozofik, Podgoricë

Luigj Berisha, Qendra e Provimeve, Podgoricë

Recensent: Mr. Anton Goçaj

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	4
2. Rregullat.....	5
3. Qëllimet e përgjithshme.....	6
4. Struktura dhe vlerësimi i provimit	7
4.1. Skema e provimit.....	7
4.2. Llojet e detyrave/pyetjeve.....	7
5. Programi i provimit.....	8
5.1. Të lexuarit dhe të kuptuarit e tekstit funksional	8
5.2. Gjuhë	9
5.3. Letërsi.....	10
5.4. Të shprehurit me shkrim	11
5.5. Veprat letrare të obliguara.....	11
6. Shembulli i testit	12
7. Fleta për përgjigje	20
8. Zgjidhja e testit me skemë për vlerësim.....	22
9. Literatura.....	26

1. HYRJE

Provimi ekstern për nxënësit e klasës IX të shkollës fillore (semimatura) është kontrollimi ekstern i standardizuar i të arriturave shkollore të nxënësve në fund të ciklit të tretë të arsimit fillor. Ky vendim bazohet në Ligjin për shkollën fillore, neni 56 ("Gazeta Zyrtare e RMZ", nr. 64/02 e 8. 11. 2002, 49/07 e 10. 08. 2007 dhe 45/10 e 04. 08. 2010), kurse mënyra dhe procedura e kontrollimit të dijes është e rregulluar me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e kontrollimit të njohurive të nxënësve në fund të ciklit arsimor ("Gazeta Zyrtare e RMZ", nr. 62 e 14. 12. 2012).

Kontrollohen njohuritë që mbështeten në pjesët kryesore të programit të mësimi të cilat tregojnë nivelin e arritjes individuale të nxënësve për lëndën e Gjuhës shqipe dhe letërsisë.

Përgatitjen e detyrave e bën Qendra e Provimeve, kurse kontrollimin e njohurive e bën Qendra e Provimeve në bashkëpunim me shkollën. Mënyrën dhe procedurën e kontrollimit të njohurive të nxënësve e rregullon Ministria e Arsimit.

Katalogu i provimit e përshkruan hollësisht provimin nga lënda e dhënë dhe u kushtohet nxënësve dhe mësimdhënësve.

Në katalogun e provimit janë cekur qëllimet e përgjithshme të provimit, është përshkruar struktura e provimit, kurse me formën e qëllimeve të provimit është thënë saktësisht përmbajtja e lëndës që i nënshtrohet provimit. Në të ndodhet edhe shembulli i testit me skemën për vlerësim.

2. RREGULLAT

Provimi nga Gjuha shqipe dhe letërsia do të mbahet në kushte të njëjta dhe në mënyrë të njëjtë për të gjithë nxënësit e klasës së nëntë të shkollës fillore.

Materiali i provimit do të paketohet në qese të veçanta dhe të sigurta, të cilat do të hapen para nxënësve menjëherë para fillimit të provimit.

Në provim nuk lejohet:

- prezantimi i rrejshëm,
- shikimi i detyrave të provimit para kohës së lejuar,
- pengimi i nxënësve të tjerë,
- përshkrimi nga nxënësi tjetër
- shfrytëzimi i mjeteve të palejuara dhe telefonit celular,
- dëmtimi i shifrës në librezën e testimit,
- mosrespektimi i sinjalit për përfundimin e provimit.

Mjetet e lejuara: lapsi i thjeshtë, goma dhe lapsi kimik/stilolapsi.

Punimi i nxënësit **duhet** të jetë i shkruar me laps kimik/stilolaps.

Pas provimit, testet do të paketohen dhe do të kthehen në Qendrën e Provimeve, ku do të organizohet vlerësimi i tyre.

3. QËLLIMET E PËRGJITHSHME

Pas përfundimit të klasës së nëntë të shkollës fillore, nxënësi duhet:

- ta njohë normën gjuhësore dhe normën drejtshkrimore dhe t'i zbatojë ato me përpikëri
- ta kuptojë përmbajtjen dhe rëndësinë e tekstit letrar dhe përmbajtjen dhe qëllimin e tekstit joletrar
- ta vlerësojë i pavarur tekstin, t'i shpjegojë dhe t'i argumentojë pohimet e veta
- të dijë ta shkruajë tekstin funksional, të bëjë përshkrimin e shkurtër ose narracionin

4. STRUKTURA DHE VLERËSIMI I PROVIMIT

4.1. Skema e provimit

(provimi zgjat 60 minuta dhe punohet pa pushim)

Pjesa I e provimit – 30 minuta

Detyrat /pyetjet nga gjuha dhe letërsia

Pjesa II e provimit – 30 minuta

- Shkrimi i tekstit joartistik

- Shkrimi i hartimit të shkurtër – përshkrimi ose rrëfimi

Përmes detyrave /pyetjeve në pjesën e parë të provimit nxënësi duhet të tregojë se

→ e kupton përmbajtjen dhe qëllimin e tekstit joletrar/përmbajtjen dhe rëndësinë e tekstit letrar

→ e njeh normën gjuhësore dhe drejtshkrimore dhe i zbaton me përpikëri

→ di ta analizojë tekstin (fragmentin ose fjalinë)

Me shkrimin e tekstit joartistik dhe hartimit të shkurtër, nxënësi duhet të tregojë se

→ di që në bazë të udhëzimeve të dhëna të shkruaj tekst apo hartim që ka lidhshmëri dhe qartësi

→ e kupton temën

→ di ta zbatojë normën dhe karakteristikat e tekstit të dhënë

→ di t'i përdorë teknikat e tregimit – përshkrimin dhe rrëfimin

→ di t'i zbatojë rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore

4.2. Llojet e detyrave/pyetjeve

→ detyrat/pyetjet e tipit të mbyllur

→ detyrat/pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë

(janë ofruar tri apo katër përgjigje prej të cilave njëra është e saktë; janë ofruar pesë ose gjashtë përgjigje prej të cilave dy ose tri janë të sakta)

→ detyrat/pyetjet e zgjedhjes alternative

(pyetjet PO-JO apo E SAKTË-E PASAKTË)

→ detyrat/pyetjet që bashkohen

(fjalët janë të grupuara në dy kolona dhe duhet të bashkohen drejt)

→ detyrat/pyetjet e tipit të hapur

→ detyrat/pyetjet e përgjigjes së shkurtër

(duhet shkruar fjalën, sintagmën, fjalinë apo shpjeguar diçka me dy-tri fjali)

→ detyrat/pyetjet e përgjigjes së gjatë

(shkrimi i tekstit funksional)

Numri i detyrave sipas fushave është dhënë në tabelën në vazhdim:

FUSHA			
GJUHË DHE TEKST JOARTISTIK	LETËRSI	TË SHPREHURIT ME SHKRIM	GJITHSEJ
10	9	1	20

5. PROGRAMI I PROVIMIT

A ka të bëjë me pjesën I të provimit

Nxënësi duhet të tregojë që e kupton tekstin joaristik dhe artistik duke u përgjigjur në pyetjet lidhur me tekstin e lexuar siç është: ftesa zyrtare, ftesa, fletë- falënderimi, kërkesa, ankesa, letra publike, lajmi/raporti, teksti shkencor, krijimi popullor (përshkrimi i pjesëve, lëndës, procedurës, dukurisë natyrore), artikulli shkencor, reportazhi, intervista, reklama, jetëshkrimi, komenti, portreti, teksti dhe fragmenti letrar.

5.1. TË LEXUARIT DHE TË KUPTUARIT E TEKSTIT FUNKSIONAL

Nxënësi duhet

→ që në shembullin e tekstit të dhënë të caktojë: llojin, autorin, temën, kujt i është kushtuar teksti; që në tekst të gjejë dhe t'i shpjegojë të dhënat dhe lidhshmërinë e tyre

→ që të dallojë dhe të formulojë temën dhe motivet e tekstit; të sqarojë domethënien e fjalëve të cituara nga teksti.

→ të dijë të dallojë dhe të gjejë stilin e kërkuar të shkrimit (letraro-artistik, shkencor-administrativ, publicistik)

5.2. GJUHË

Nxënësi duhet të dijë

→ të dallojë dhe të gjejë fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme (fjalëve emërore t'u caktojë gjininë, numrin dhe rasën, kurse foljeve vetën, gjininë dhe numrin)

→ të dallojë dhe të gjejë funksionin e fjalës në fjali (kryefjalën, cilësonin, ndajshtimin, kundrinorin, rrethanorin, kallëzuesin emëror dhe foljor)

→ të njohë sintagmën e rasës me parafjalë, të përdorë drejt rasat dhe sintagmat e rasave me parafjalë, të caktojë dhe të përdorë sinonimin rasor

→ të njohë dhe të përdorë drejt format, mënyrat dhe kohët e foljeve (paskajoren, kohën e tashme, kohën e kryer, kohën e kryer të thjeshtë, kohën e pakryer, kohën e kryer të plotë, mënyrën urdhërore, kohën e ardhme dhe kohën e ardhme të përparme, kushtoren, ndajshtimet foljore - të tashmin dhe të kaluarin, mbiemrin foljor – vepror dhe pësor)

→ t'i dallojë dhe t'i përdorë fjalitë e thjeshta, të zgjeruarat dhe periudhat (fjalitë e përbëra); marrëdhëniet bashkërenditëse dhe nënrenditëse; fjalinë veprorë dhe joveprorë; fjalinë e ndërfutur; fjalinë pavetore, fjalinë e paplotë (fjalinë mungesore)

→ t'i njohë ndryshimet tingullore dhe shmangien prej tyre dhe di t'i zbatojë rregullat gjatë shkrimit të fjalëve në të cilat kanë ndodhur ndryshimet tingullore (palatalizimi, barazimi i bashkëtingëlloreve sipas tingëllimit, barazimi i bashkëtingëlloreve sipas vendit të krijimit të tingullit, humbja e bashkëtingëllores, ë-ja e pazëshme, metafoia)

→ t'i zbatojë rregullat e përputhjes (kongruencës)

→ që mbi rrënjën e dhënë të krijojë familjen e fjalës

→ t'i dallojë sinonimet homonimet dhe antonimet; di që fjalëve të dhëna t'u caktojë sinonimet, homonimet, antonimet

→ të dallojë, gjejë, të shpjegojë idiomën, frazeologjizmin

→ të dallojë dhe gjejë fjalët e huaja dhe slengun (zhargonin) dhe t'i zëvendësojë me shprehje të standardizuara

→ të njohë ligjëratën e drejtë dhe që shembujt e thjeshtë të ligjëratës së drejtë t'i shndërrojë në ligjëratë të zhdrejtë dhe anasjelltas

→ t'i zbatojë rregullat e drejtshkrimit:

- i shkruan drejtë pjesëzën s' dhe të tjerat,
- di kur shkruhet shkronja j ndërmjet i-së dhe e-së, i-së dhe a-së (psh. Selvije, Marije, Zija etj.)
- shkruan drejt numrat themelor dhe rreshtor (rendor) deri në 1000, me shkronja dhe me numra
- përdor drejt shkronjën e madhe te emrat e përveçëm dhe mbiemrat pronor të dalë prej tyre dhe në shprehjet e respektit, shkronjën e madhe dhe të vogël gjatë shkrimit të emrave që përbëhen nga më shumë fjalë
- shkruan drejt shkurtesat
- shfrytëzon shenjat e pikësimit (në fund të fjalisë; në ligjëratën e zhdrejtë; presjen gjatë numërimit, pranë ndajshtimit, te fjalia e ndërfitur, kur ka inversion te fjalitë, kllapat)

5.3. LETËRSI

Nxënësi duhet që

→ të dijë cilës gjini letrare i përket teksti (lirikë, epikë, dramatike) dhe për të cilin lloj të tekstit letrar bëhet fjalë (përrallë popullore dhe autoriale, fabul, anekdotë, roman, satirë, tregim realist, tregim fantastik, vjershat lirike – përshkruese, e dashurisë, patriotike, sociale, mendimtare, sonet; epiko-lirike – balada, romanca, kënga epike; dramatike – komedia, tragjedia)

→ ta caktojë dhe formulojë temën, motivet (statike dhe dinamike) dhe idetë në tekst; të sqarojë domethënien e fjalëve të cituara nga teksti

→ të caktojë vendin dhe kohën e ngjarjes dhe të sqarojë përse ka ndodhur diçka

→ të dijë që në tekstin letrar të dallojë rrjedhën kronologjike dhe retrospektive të ngjarjes, format e rrëfimit (përshkrimin, të treguarit, dialogun); di të njohë tregimtarin e gjithanshëm, format e të rrëfyerit – rrëfimin në vetën e parë dhe rrëfimin në vetën e dytë; di të njohë dhe emëroi pjesët e fabulave (hyrjen, thurjen, kulminacionin, shturjen (zgjidhjen))

→ të njohë karakteristikat e tekstit dramatik (dialogun, monologun, didaskalitë/remarket)

→ të dijë të caktojë personazhet kryesore dhe dytësore dhe vetitë e veçorive të tyre; të vërej motivet për sjelljen e personazheve letrare

→ të dijë që në vjershën lirike të dallojë strofën, vargun (të lidhur dhe të lirë), rimën (çift , të kryqëzuar, të përmbysur)

→ të dijë të dallojë figurat stilistike dhe funksionin e tyre stilistik: epitetin, krahasimin, personifikimin, onomatopenë, hiperbolën, metaforën, gradacionin (shkallëzimin, kontrastin, simbolin, alegorinë, asonancën, aliteracionin)

→ të dallojë mjetet shprehëse teatrale (skenografinë, kostumet, skenën, ndriçimin, rekuizitat)

→ të njohë mjetet shprehëse të filmit (projektin, planin, këndin e xhirimit (rekursin)); shënimet e skenarit dhe librat e xhirimit

B *ka të bëjë me pjesën II të provimit*

Nxënësi duhet të dijë të shkruaj tekstin e dhënë (shpalljen, lajmin, letrën – zyrtare, lutjen, urimin, falënderimin, lajmërimin – zyrtar dhe jozyrtar, ftesën - zyrtare dhe jozyrtare, arsyetimin – zyrtar dhe jozyrtar... ; hartimin e shkurtër – përshkrimin, rrëfimin) duke respektuar udhëzimet për shkrimin e tekstit, formës së tekstit dhe parimet e formësimit (hyrjen, shtjellimin,

përfundimin, paragrafët, shkrimin e emrit të vendit, datës dhe adresës se kujt i drejtohet, emrin dhe mbiemrin e të adresuarit, margjinat...), bën kujdes për rregullsinë gjuhësore, kuptimin, lidhshmërinë dhe tërësinë e tekstit

5.4. TË SHPREHURIT ME SHKRIM

Shkrimi i tekstit joartistik

Nxënësi duhet t'i

- dallojë stilet e ndryshme funksionale (shkencor, administrativ, publicistik) dhe t'i zbatojë ato në shkrim
- zbatojë normat drejtshkrimore dhe gjuhësore të gjuhës shqipe

Shkrimi i hartimit të shkurtër

Nxënësi duhet të

- shkruaj hartimin duke respektuar udhëzimet e dhëna
- zbatojë normën drejtshkrimore dhe gramatikore të gjuhës shqipe

5.5. VEPRAT LETRARE TË OBLIGUARA

- 1. N.Frashëri:** "Bagëti e Bujqësi", "Dëshira e vërtetë e shqiptarëve", fragment
- 2. A.Z.Çajupi:** "14 vjeç dhëndër"
- 3. P.P.Njegosh:** "Kurora e maleve", fragment
- 4. E.Heminguej:** "Plaku dhe deti", fragment
- 5. Martin Camaj:** "Vjersha", fragment
- 6. Ismail Kadare:** "Një mbrëmje në Lurë"
- 7. Ali Podrimja:** "Rrëfimi"

6. SHEMBULLI I TESTIT

Lexo tekstin dhe pastaj zhvillo detyrat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

- 1) Amerikani më mendjemprehtë ka lindur si Semjuell Klemens më tridhjetë nëntor të vitit 1835 në Misuri, kurse ka vdekur me famë botërore në vitin 1910.
- 2) Fëmijërinë e ka kaluar në breg të lumit Misisipi. 3) Dëgjonte me vëmendje rrëfimet e udhëtarëve, duke përcjellë me shikim anijet me avull që lundronin ngadalë nëpër lumin e gjerë.
- 4) Ëndërronte që një ditë të shkëputej teposhtë rrjedhës së lumit. 5) Pas vdekjes së babait familja u gjet në një gjendje të vështirë materiale dhe vogëlushi Semjuell Klemens e braktisi shkollimin që të gjejë punë. 6) E gjen në një shtypshkronjë dhe në të kryen punë të ndryshme. 7) Si dhe shumicën e moshatarëve të tij në Amerikë, edhe të riun Semjuell Klemens e tërheqin vendet e largëta. 8) Udhëton nga qyteti në qytet duke bërë punë të ndryshme, të shpeshtën e rasteve në shtypshkronjat lokale. 9) Atëherë i plotësohet ëndrra fëmijërore-mëson për të pilotuar nëpër lumenj dhe bëhet timonier në një anije me avull në Misisipi. 10) Në vitin 1851 filloi lufta qytetare në Amerikë, e cila do t'i ndryshojë traditat dhe mënyrën e deriatëhershme të jetës.
- 11) Në fillim të luftës është paraqitur vullnetarë, por së shpejti e kuptoi se uniforma nuk është për të. 12) Shkruan tregime të vogla humoristike të cilat fillon t'i firmos me pseudonimin Mark Tuen. 13) Këtë emër e mori sipas shprehjes së marinarëve për thellësinë e lumit mark twain, që do të thotë se lumi është mjaft i thellë dhe se anija mund të lundrojë e sigurt nëpër të pa prekur fundin e lumit. 14) Atij edhe më tej nuk i rrihet në një vend dhe udhëton si reporter në Havai.
- 15) Pas kthimit merr ftesën për të mbajtur ligjërata për përvojat e tij të udhëtimit. 16) Tuen këtyre thirrjeve do t'u përgjigjet me kënaqësi dhe u bë mjeshtër i vërtetë i paraqitjeve publike.
- 17) Këto ligjërata do ta përmirësojnë stilin e shkrimit të tij nga i cili pastron të gjitha gjërat e tepërta, duke arritur kështu thjeshtësinë, saktësinë dhe të shprehurit tërheqës, karakteristik për të.
- 18) Humori i mprehtë, rrëfimi i lehtë dhe stili original pranohen në mënyrë të shkëlqyer nga lexuesit.

1. Cilit lloj të tekstit i përket teksti që posa e ke lexuar?

- A) biografi
- B) raport
- C) udhëpërshkrim

Qarko shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

2. A) Cili është emri i vërtetë i Mark Tuenit?

B) Përshkruaj komentet e autorit të tekstit i cili sqaron shkaqet pse Tueni i pëlqen publikut.

(1 pikë)

3. Me të cilin stil funksional është shkruar teksti?

- A) shkencor
- B) letrar
- C) publicistik

Qarko shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

4. Lexo fjalinë numër 1 pastaj shkruaj numrat e kërkuar:

- A) ditën e lindjes me shifër _____
- B) vitin e lindjes me shkronja _____

(1 pikë)

5. Fjalës së theksuar (errësuar) në fjalinë e katërt caktoja gjininë, numrin dhe rasën.

Gjinia _____
Numri _____
Rasa _____

(3 pikë)

6. Dëgjonte me vëmendje rrëfimet e udhëtarëve duke përcjellë anijet me avull.

Qarko shkronjën para funksionit të fjalës në të cilin janë përdorur fjalët anijet me avull në fjalinë e dhënë.

- A) përcaktor
- B) kundrinë
- C) kryefjalë

(1 pikë)

7. A) Tuen këtyre thirrjeve do t'u përgjigjet me kënaqësi...

Fjalës së nënvizuar nga shembulli i dhënë gjeja sinonimin përkatës.

B) Plotëso fjalinë në mënyrë të tillë që foljen e dhënë ndërmjet kllapave do ta zëvendësosh me kushtoren.

Atëherë _____ ëndrra fëmijërore.

(I plotësohet)

(1 pikë)

8. A) Qarko shkronjën para fjalisë e cila, sipas mendimit tënd, stilistikisht është më e arritur.

- A) Udhëton nga qyteti në qytet duke bërë punë të ndryshme.
- B) Udhëton nga qyteti në qytet dhe bën punë të ndryshme
- C) Udhëtonte nga qyteti në qytet dhe bënte punë të ndryshme.

B) Cila formë e foljes i ka shërbyer shprehjes më të arritur.

(1 pikë)

9. A) Fjalën avull nga fjalia e 3-të që është dhënë në njëjës kaloje në shumës.

B) Formo foljen e prejardhur duke i shtuar foljes këput një parashtesë.

(1 pikë)

Lexo tekstin pastaj zhvillo detyrat 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19.

Portokalli fluturues

Emri im është Portokall. Po, ky jam unë. Unë jam një portokall. Ndoshta ti mendon se jam portokalli yt? Apo portokalli i shokut tënd. Apo portokalli i juaj. Nuk ka rëndësi. Unë qëndroj lart në pemë. Mëma – Pemë më ushqen. Unë rritëm me ujë, ajër dhe diell. Të gjitha m'i siguron Mëma- Pemë. Vetë Mëma – Pemë ushqehet nga Mëma – Tokë. Por unë nuk jam vetëm. Me qindra e qindra portokaj të tjerë qëndrojnë të varur në pemë dhe ushqehen e rriten si unë. "Është bukur"- thonë të gjithë.

Mos u habisni ! ne portokajtë , mund të flasim me njëri-tjetrin. Kuptohet , jo si njerëzit, që flasin gjithë kohën. Unë mund të flas jo vetëm me portokajtë që kam pranë, por edhe me ata që janë larg. Unë mund të flas me portokaj të tjerë, të cilët janë oqeanë larg, që rriten në vende ku jetojnë bizonë të mëdhenj, të zinj, njerëz me ngjyrë e ku bie kaq shumë shi, sa Mëma – Pemë pothuaj përmbysen e shkulet nga Mëma – Tokë. Një ditë ndodhi diçka shumë e trishtuar. Një portokall ra në tokë. Aty pranë kaluan dy djem të vegjël. Ata ishin vetëm budallenj dhe filluan të grindeshin.

“ E pashë unë i pari”- bërtiste njëri.

“ E dua unë”,- bërtiste tjetri.

Kështu filluan luftën, se kush do ta merrte portokallin. Njërit i doli gjak nga hunda. Tjetri u rrëzua. Ku ? Tamam mbi portokallin që qëndronte në tokë e që dëshironte kaq shumë t’i bënte të lumtur. Portokalli u shtyp, u ça dhe gjithë lëngu kulloi në tokë. Djali që ishte më i fortë , mori portokallin. Kjo ngjan me atë, që kur grinden dy vajza ato qajnë të dyja. Vajza që derdh më shumë lot, fiton. I bie që ajo të marr portokallin.

Mos ëndërro budallallëqe të tilla, sesi mund të luftosh për ta pasur të gjithë portokallin për vete . Përpiqu të gjesh mënyra sesi mund ta ndash portokallin me miqtë e tu, me të tjerët. Edhe të rriturit mund të mësojnë të ëndërrojnë të bëjnë gjëra të bukura. Ka gjithmonë një portokall – mundësi.

(Johan Galtung)

10. Çfarë teksti është proza e mësipërme?

(1 pikë)

11. Ku qëndron portokalli?

- A) Në duart e djalit
- B) Në një pjatë
- C) Mbi tavolinë
- D) Lart në pemë

Qarko shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

12. Kush është personazhi kryesor në tekst?

(1 pikë)

13. Në vendin e lënë zbrazët (mbi vijë) shkruaj numrin sipas renditjes kronologjike të ngjarjes.

_____ Djali që ishte më i fortë, mori portokallin.

_____ Një portokall ra në tokë.

_____ Me qindra e qindra portokaj qëndrojnë të varur në pemë

_____ Portokalli u shtyp, u ça dhe gjithë lëngu kulloi në tokë.

(2 pikë)

14. Si komunikojnë portokajtë me njëri-tjetrin?

(1 pikë)

15. Përgjigju në pyetje: Nga ushqehet portokalli?

(1 pikë)

16. Në fjalinë "Unë jam një portokall" është përdorur figura stilistike:

- A) krahasimi
- B) simboli
- C) personifikimi
- D) anafora

Qarko shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

17. Ligjëratën e drejtë "E pashë unë i pari"- bërtiste njëri" kaloje në ligjëratë të zhdrejtë:

(1 pikë)

18. Nga fjalia "Aty pranë kaluan dy djem të vegjël" përshkruaji fjalët e ndryshueshme:

(2 pikë)

19. Cilës fushë leksikore i takon fjala "portokall"?

- A) kafshë
- B) gjallesë
- C) fruta

Qarko shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

20. Janë dhënë dy tema për të shprehurit me shkrim. Qarko numrin para temës të cilën do ta zhvillosh. Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Kij kujdes që në aspektin gjuhësor fjalia të jetë e qartë, e kuptueshme dhe mos të ketë gabime gjuhësore.

1. Njoftimi zyrtar

Këshilla për hartimin e njoftimit zyrtar:

1. Pjesa hyrëse

Shkruaj

- kush e bën njoftimin dhe për ç' gjë bëhet njoftimi

2. Zhvillimi

Shkruaj

- kur dhe ku pritet të ndodhë ngjarja në njoftim

3. Përfundimi

Shkruaj

- kujt i kushtohet njoftimi

2. Përshkrimi i fotografisë



Duke respektuar kërkesat në vazhdim përshkruaje fotografinë e dhënë që pasqyron heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

1. Hyrja

- fillo përshkrimin me frymëzimet që u ka bërë artistëve heroi ynë kombëtar
- trego për vendndodhjen që di ti të kësaj pamje monumentale që është dhënë në këtë fotografi

2. Zhvillimi

- trego për përmbajtjen e fotografisë
- përshkruaj të gjithë përbërësit që duken në të
- përmend element nga fotografia që Skënderbeun e bënë hero të përjetshëm të popullit tonë

3. Përfundimi

- mbylle përshkrimin duke cekur përshtypjet tua për fotografinë monumentale të heroit tonë kombëtar

8. ZGJIDHJA E TESTIT ME SKEMË PËR VLERËSIM

1.

A)

1 pikë

2.

A) Është shkruar emri i vërtetë i Mark Tuenit -Semjuell Klemens

B) Është shkruar - Tueni i pëlqente publikut për shkak të humorit të mprehtë, rrëfimit të lehtë dhe stilit origjinal

1 pikë

3.

C)

1 pikë

4.

A) Është shkruar dita e lindjes me shkronja: tridhjetë

B) Është shkruar viti i lindjes me shkronja - një mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë

1 pikë

5.

Fjalës së errësuar **dritë** i është caktuar:

Gjinia- femërore

Numri- njëjës

Rasa-emërore

3 pikë

6.

B)

1 pikë

7.

A) Është shkruar sinonimin -me ëndje (me dëshirë)

B) Është plotësuar fjalia me kushtoren-do t'i plotësohej

1 pikë

8.

A)

B) Është shkruar-forma përcjellore

1 pikë

9.

A) Fjala e dhënë në njëjës **avull** është kaluar në shumës - avuj

B) Është formuar folja e prejardhur shkëput duke i shtuar parashtesën sh foljes këput.

1 pikë

10.

Është shkruar-tekst artistik

1 pikë

11.

A)

1 pikë

12.

Është shkruar-portokalli

1 pikë

13.

Nëse janë shkruar numrat me këtë rend para fjalive:

4. Djali që ishte më i fortë , mori portokallin.

2. Një portokall ra në tokë

1. Me qindra e qindra portokaj qëndrojnë të varur në pemë.

3. Portokalli u shtyp, u ça dhe gjithë lëngu kulloi në tokë

2 pikë për renditje të saktë kronologjike të ngjarjes; 1 pikë për dy renditje të sakta.

14.

Është shkruar- ndryshe nga njerëzit (jo si njerëzit)

1 pikë

15.

Është shkruar- portokalli ushqehet nga pema e cila rritet nga toka.

1 pikë

16.

C)

1 pikë

17.

Është shkruar ligjërata e zhdrejtë-Njëri bërtiste se e pa ai i pari. (Njëri bërtiste se e kishte parë ai i pari)

1 pikë

18.

Janë përshkruar fjalët e ndryshueshme: kaluan (folje), dy (numëror), djem (emër) dhe të vegjlit (mbiemër)

2 pikë nëse nxënësi ka gjetur të gjitha fjalët e ndryshueshme; 1 pikë për dy fjalë të ndryshueshme.

19.

C)

1 pikë

20. Të shprehurit me shkrim

1. NJOFTIMI ZYRTAR

8 pikë

Për këtë pjesë do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- harton një njoftim zyrtar me elementet që duhet të ketë njoftimi zyrtar
- shpreh qartë, përmes detajeve dhe shprehjeve të përzgjedhura, funksionin e këtij njoftimi
- përdor detaje mbështetëse
- ka qartësi mendimi

KRITERI II: STRUKTURA

2 pikë

- respekton elementet e strukturës së njoftimit zyrtar
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **2 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- ka fjalor të pasur
- ka stil origjinal
- përdor fjali të larmishme në modele, gjatësi dhe ritëm

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta
- ka saktësi drejtshkrimore

2. PËRSHKRIMI I FOTOGRAFISË

8 pikë

Për këtë pjesë do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- harton një përshkrim ku tregon për fotografinë e dhënë monumentale të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu
- shpreh qartë, përmes detajeve dhe shprehjeve të përzgjedhura, të veçantën e kësaj fotografie
- përdor detaje mbështetëse

- ka qartësi mendimi

KRITERI II: STRUKTURA

2 pikë

- respekton elementet e strukturës së një përshkrimi
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **2 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- ka fjalor të pasur
- ka stil origjinal
- përdor fjali të larmishme në modele, gjatësi dhe ritëm

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta
- ka saktësi drejtshkrimore

Pjesa I e provimit-numri i pikëve: **00** (%)

Pjesa II e provimit-shkrimi i tekstit joartistik-shkrimi i hartimit të shkurtër – përshkrimi ose rrëfimi -numri i pikëve: **8** (%)

Numri i përgjithshëm i pikëve në test: **00** (100 %)

9. LITERATURA

- Dr. Bahri Beci, “Komunikojmë dhe hartojmë – përdorim gjuhën”-Gjuha shqipe 7 për klasën e shtatë të shkollës fillore nëntëvjeçare-Libri i nxënësit, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2007;
- Dr. Bahri Beci, “Komunikojmë dhe hartojmë- përdorim gjuhën”-Gjuha shqipe 7 për klasën e shtatë të shkollës fillore nëntëvjeçare-Fletorja e punës, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2007;
- Pjetër Dreshaj, “Hapim dritaren”, Letërsia, Libri i nxënësit për klasën e shtatë të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2007;
- Pjetër Dreshaj, “Djepi i artë”, Ditari i leximeve për klasën VII të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2007;
- Dr. Bahri Beci, “Komunikojmë dhe hartojmë-përdorim gjuhën”-Gjuha shqipe 8 për klasën e tetë të shkollës fillore nëntëvjeçare-Libri i nxënësit, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2008;
- Dr. Bahri Beci, “Komunikojmë dhe hartojmë-përdorim gjuhën”-Gjuha shqipe 8 për klasën e tetë të shkollës fillore nëntëvjeçare-Fletorja e punës, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2008;
- Pjetër Dreshaj, “Dritaret e hapura”, Letërsia, Leximi letrar për klasën VIII të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2008;
- Pjetër Dreshaj, “Djepi i artë na rriti”, Ditari i leximeve për klasën VIII të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2008;
- Dr. Bahri Beci, “Gjuha shqipe, sa e bukur, sa e mirë!”-Gjuha shqipe 9 për klasën e nëntë të shkollës fillore nëntëvjeçare-Libri i nxënësit, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2009;
- Dr. Bahri Beci, “Gjuha shqipe, sa e bukur, sa e mirë!”-Gjuha shqipe 9 për klasën e nëntë të shkollës fillore nëntëvjeçare-Fletorja e punës, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2009;
- Hava Pereziziq dhe Prelë Gjolaj, “Në gjurmët e dijes”, për klasën e nëntë të shkollës fillore nëntëvjeçare, Leximi letrar, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2009;
- Hava Pereziziq dhe Prelë Gjolaj, “Udhëtoj në botën e librit”, për klasën e nëntë të shkollës fillore nëntëvjeçare, Ditari i leximeve, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Podgoricë, 2009.